

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Ragip Namani e Gani Avdiu, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit L.K., nga fshati ... Komuna e Kamenicës, kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale – Komisioni për Ankesa në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të ushtruar përmes përfaqësuesit të autorizuari, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1625/2012 të datës 10.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.04.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - Komisioni për Ankesa në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1625/2012 i datës 10.10.2016, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1625/2012 i datës 10.10.2016, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadija e paditësit L.K., nga fshati ... Komuna e Kamenicës, dhe është anuluar aktvendimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, K.A.nr327/2012 i datës 16.11.2012, dhe çështja është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek i padituri.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura, përmes përfaqësuesit të autorizuar për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ashtu siç rrjedhë nga përmbajtja e ankesës. Propozon që ankesa të aprovohet dhe aktgjykimi i ankimuar A.nr.1625/12 i datës 10.10.2016, të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkalles së parë në rishqyrtim dhe rivendosje duke refuzuar padinë e paditësit.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar paditësi, përmes avokatit V.H., nga Prishtina, me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi për konflikt administrativ kundër aktvendimit të paditurit Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale - Komisionit për Ankesë në Prishtinë, K.A.nr.327/2012 të datës 16.11.2012, sepse konsideron se vendimi i kundërshtuar me padi është i kundërligjshëm, dhe si i tillë duhet të anulohet, për arsye se në momentin kur ka vendosur organi i shkallës së dytë në procedurë administrative lidhur me ankesën e paditësit KPMM ka qenë në posedim të faturës të datës 30.06.2012.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi aktvendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave duke u bazuar në provat e administruara si dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, vendosi që ta aprovoi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe çështjen ta kthej në rishqyrtim dhe vendosje. Me arsyetim se vendimi i kontestuar përmban të meta të tilla nga neni 84 par.2 dhe neni 85 i LPA-së, për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij, dhe se vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Sepse në arsyetim nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kushtëzuar, ngase në shkresat e lëndës shihet se paditësi posedon faturën e datës 30.06.2012, në të cilën shihet se rëra e cila është gjendur në mjetin motorik është blerë të subjekti afarist i cili ka pasur licencë të lëshuar nga ana e KPMM-së, e cila ka poseduar leje të veçantë, për të kryer punët seperacioni duke përfshirë seperacion.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës ka konstatuar se padia e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së.

Ndërsa sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike gjithashtu kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit në padi janë të bazuara, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës nuk është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sepse akti i tillë individual nuk është i plotë dhe përmbajtjesor për tu vlerësuar ligjshmëria e tij si në vështrim të nenit 9 të LKA-së, dhe se i njëjti përmban të meta esenciale. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pretendimet ankimore të paditurës së aktvendimi i kontestuar është në përputhje me nenin 84 dhe 85 të LPA-

së, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi ngase vlerëson se akti administrativ patjetër duhet të jetë në kuptim të neneve 84 par.2, 85 dhe 86 par.1 të Ligjit për Procedurën Administrative. Vlerësimin juridik të paditurës, kjo gjykatë nuk mund ta merr si të rregullt dhe të ligjshëm për arsye se vendimi i ankimuar përmban të meta të tilla për shkak të së cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljen thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurë Administrative.

Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84, par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ i kontestuar, duhet patjetër të përmbajë, përveç tjerash, edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilën bazohet akti etj.

Akti administrativ patjetër duhet të jetë i arsyetuar, ngase neni 85 i LPA-së, ka përcaktuar: “Përveç rasteve kur ligji vet parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte të cilat pjesërisht ose tërësisht: mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në ndonjë mënyrë tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë vendim në lidhje me kërkesat për rishqyrtim apo ankimet, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj.

Arsyetimi duhet të formulohet qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit (neni 86, par.1 i të njëjtit ligj). Arsyetimi me të dhëna të paqarta, kontradiktore ose të pasakta, është i barasvlershëm me mungesën e arsyetimit (neni 86.3) të LPA-së. Andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e anulon vendimin e të paditurës Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale K.A.nr.327/2012 të datës 16.11.2012.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje të konstatuar kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, nga shkak se e paditura me asnjë provë nuk e ka vërtetuar një gjendje të tillë të krijuar për mos mundësin e vendosjes ashtu siç parashihet me dispozitat e neneve të lartcekura të LPA-së. E paditura me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e saj ankimore, ndërsa nga vendimi i kontestuar nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike, ngase nuk ka bërë shqyrtimin e provave relevante - faturës se datës 30.06.2012, të cilën e ka prezantuar paditësi me të cilën shihet se rëra është blerë te subjekti afarist që paditësi pretendon se ka pasur licencë të lëshuar nga KPMM. Andaj, pretendimet ankimore të paditurës së paditësi me ankesë ka bashkangjitur këtë provë për ti ikur përgjegjëses ndaj të paditurit, ky kolegji nuk i aprovoi sepse vlerësoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara dhe pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Sa i përket pretendimeve tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktgjykimit të atakuar, për një gjendje tjetër faktike nga ajo që ka pretenduar me aktet administrative. Gjukata e Apelit konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara, se vendimi i kontestuar i të paditurës përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Meqë vendimi i organit kompetent duhet të jetë i plotë, përmbajtjesor dhe i arsyetuar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit me të cilin ka anuluar vendimin e të paditurës, e pasi që me thëniet ankimore një aktgjykim i tillë nuk mundë të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.416/16, me datë 11.04.2017

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi